



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr.Regj.Them. 9216/4587/2292
Data e regjistrimit 11.11.2014

Nr. Vendimi 3362
Data e vendimit 20.10.2016

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga Gjyqtarët :

BARI SHYTI	-	Kryesues
LINDITA SINANAJ	-	Anëtare
AMARILDO LAÇI	-	Anëtar

Asistuar nga sekretare gjyqësore, **Mimoza Tafa**, në Tiranë, sot më datë **20.10.2016**, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen me Nr.Regj.Them. **9216/4587/2292** datë **11.11.2014**, që iu përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Shoqëria “Pema Konstruksion” sh.p.k, me NIPT L17511301H dhe seli në adresën: Lagjia Nr.5, Shtëpi private Laç, me përfaqësues ligjor z. Bujar Roçi.

I PADITUR: 1.Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.
2.Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë.

OBJEKTI: 1.Anullimin e Aktit Administrativ/shfuqizimin tërësisht të Njoftim Vlerësimi të Detyrimit Tatimor Nr. 5859 Prot, dt. 27.11.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.
2.Anullimin e Aktit Administrativ/shfuqizimin pjesërisht të Vendimit Nr. 22006/1 Prot, dt. 04.03.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, për pjesën që lënë në fuqi Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr. 5859 Prot, dt. 27.11.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.

3.Zgjidhjen e pasojave, duke detyruar të paditurin Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë për kthimin e shumës së paguar për efekt ankimi.

BAZA LIGJORE: Neni 31, 32/a, 43, 153, 154, 156 të Kodit të Procedurës Civile. Neni 7/a, 11/1, 15/a, 18/1/a të Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative". Neni 115, 118, 119 të K.Pr.Administrative. Ligji Nr.9920, dt. 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R. Shqipërisë", i ndryshuar, neni 106-110.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.3920, datë 08.07.2014, ka vendosur:

- *Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova.*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala paditëse Shoqëria "Pema Konstruksion" sh.p.k, me anë të të cilit kërkon ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesë padisë.

Shkaqet e parashtruara në ankim.

- ✓ Ne nuk jemi dakord me vendimin e mësipërm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, pasi ai është marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat e administruara në gjykim.
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, ka nxjerrë Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr. 5859 Prot, dt. 27.11.2013, në bazë të Akt - Konstatimit Nr.0292789, datë 26.09.2012 dhe Proces-Verbalin e Gjjobës Nr. 0157333, datë 26.09.2012.
- ✓ Në bazë të ankimit të paditësit, Drejtoria e Apelimit Tatimor, me Vendimin Nr. 22006/1 Prot, dt.04.03.2014 vendosi të shfuqizojë detyrimet, kamatëvonesat dhe gjrobat, në lidhje me 9 punëtor dhe lënien në fuqi në lidhje me 7 punëtor të Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr. 5859 Prot, dt. 27.11.2013.
- ✓ Këto detyrime janë vendosur në kundërshtim me ligjin, pasi shoqëria "Pema Konstruksion" sh.p.k. për fazën në të cilën ndodheshin punimet në datën e kontrollit, 26.09.2012, punonte me nënkontraktor me të cilët ka lidhur Akt-Marrëveshje në datën 25.09.2012, datë në të cilën kanë filluar edhe punimet në kantier. Pra, në datën e kontrollit nga organet tatimore kishte vetëm një ditë që kishte filluar puna ndërtimore.
- ✓ Të gjithë punonjësit e ndodhur në kantier në datën e kontrollit nga inspektorët tatimor kanë qenë të punësuar nga nënkontraktorët e paditësit, për të cilët ne kemi edhe listëpagesat e periudhës tatimore Shtator 2012, të subjekteve "Idajet Allmuca" dhe "FAEA-EVER" sh.p.k..
- ✓ Kjo gjë pranohet edhe nga Drejtoria e Apelimit Tatimor në vendimin e saj për 9 të punësuar të nënkontraktorëve, por nuk e pranon për 7 të tjerë, ku dy prej tyre janë Flor Kotarja dhe Ardan Aka. Në lidhje me punonjësin Flor Kotarja, nga listëpagesa e muajit

shtator 2012 rezulton që të jetë i punësuar i shoqërisë "FAEA-EVER" sh.p.k. Argumentimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se nga list-pagesat e shoqërisë "FAEA-EVER" sh.p.k e muajit Shtator 2012 rezulton që të jetë regjistruar një person me emrin Florie Kotarja dhe jo Flor Kotarja, prandaj kemi të bëjmë me dy persona të ndryshëm, është absurd dhe jo logjik.

- ✓ Nga pala e paditur nuk u paraqit ndonjë provë që kemi të bëjmë me dy persona të ndryshëm. Ndryshimi vjen vetëm nga gabimi në shënimin e emrit të tij. Në bazë të nenit 35/1, të Ligjit Nr. 49/2012, pala e paditur kishte barrën e provës të provojë që akti administrativ është i ligjshëm dhe jo sic argumenton gjykata që barrën e provës e ka paditësi për të vërtetuar që akti administrativ është i paligjshëm. Gjykata nuk e ka zbatuar këtë kriter të ligjit të posacëm gjatë gjykimit, duke transferuar barrën e provës tek paditësi në kundërshtim me ligjin.
- ✓ Fakti është që, punimet kanë filluar vetëm një ditë para kontrollit (25.09.2012) dhe vetë paditësi (në cilësinë e porositësit) nuk i njihte të punësuarit e nënkontraktorëve, por në të gjitha rastet, paditësi nuk mban përgjegjësi as në bazë të ligjit dhe as në bazë të akt-marrëveshjeve të lidhura me dt.25.09.2012 me nënkontraktorët e tij, sic edhe argumentuam më sipër.
- ✓ Gjithashtu, nga përmbajtja e nenit 119, të Ligjit Nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore", i ndryshuar, del fare e qartë që tatimpaguesi mban përgjegjësi për mosdeklarimin e punonjësve të tij dhe jo të kontraktorëve të tij. Më e qartë bëhet ky fakt, nëse lexojmë nenin 119, të Udhëzimit Nr. 24, dt. 02.09.2008 "Për Procedurat tatimore në R.Sh." i cili rregullon më në detaje këtë moment.
- ✓ Paditësi e ka përmbushur detyrimin e tij me nënshkrimin e akt-marrëveshjeve me nënkontraktorët, ku në mënyrë specifike vendoset detyrimi për ata që të sigurojnë të gjithë të punësuarit e tyre.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Si dëgjoi relatimin e Gjyqtarit Bari Shyti, diskutoi në tërësi rrethanat faktike dhe ligjore të çështjes, vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe pretendimet e parashtruara në ankim:

V Ë R E N

Se vendimi Nr.3920, datë 08.07.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë i zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural për pasojë ai duhet të lihet në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Nga aktet shkresore që përmban fashikulli i gjykimit dhe parashtrimet e palëve ndërgjyqëse në seancë gjyqësore gjatë gjykimit në shkallë të parë, rezultojnë këto fakte:

Shoqëria "Pema Konstruksion" sh.p.k. me NIPT L17511301H, me objekt aktiviteti ndërtime objektesh, ura, prita, ujësjellësa, kanalizime, punime mbrojtje, ndërtime civile dhe ekonomike, rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike dhe veshje fasadash etj, ka marrë përsipër ndërtimin e nje godine banimi 5 katësh, në fshatin Qesarak, Komuna Dajt të Tiranës.

Kryerja e punimeve do të realizohej nga dy nënkontraktorët shoqëria "FAEA EVER" sh.p.k. dhe personi fizik "Idajet Allmuça", me të cilët pala paditëse kishte lidhur dy akt marrëveshje të vecanta në datën 25.09.2012.

Inspektorët e verifikimit në terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë janë paraqitur në kantierin e ndërtimit në datë 26.09.2012, ora 11.45 dhe kanë konstatuar 16 punonjës, për të cilët nuk është paraqitur listë pagesë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas akt konstatimit nr.0992789.

Rezulton se për këtë shkak është gjobitur me 1.600.000 lekë dhe është ngarkuar me detyrimet tatimore përkatëse lidhur me sigurimet shoqërore dhe të ardhurat personale.

Me njoftim vlerësimin tatimor nr. 5859 prot, datë 27.11.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë pala paditëse është njoftuar për pagesën e detyrimeve tatimore, kamatë vonesave dhe gjobave në masën 1.757.117 lekë.

Kundër këtij njoftim vlerësimi tatimor paditësi ka bërë ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, duke kërkuar faljen e gjobave sepse punëtorët nuk ishin të saj, por të nënkontraktorëve me të cilët kishte lidhur akt-marrëveshjet e mësipërme.

Rezulton se pala e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin Nr.22006/1, datë 04.03.2014 e ka ndryshuar këtë njoftim vlerësimi tatimor për pjesën e detyrimeve, kamatë vonesave dhe gjobave lidhur me 9 punonjës të figuronin të deklaruar nga dy nënkontraktorët e paditësit; shoqëria FAEA EVER sh.p.k dhe personi fizik Idajet Allmuça. Ndërsa për 5 punonjës të pidentifikuar që ishin larguar dhe dy punonjës të tjerë Flor Kotarja dhe Ardjan Aka, njoftim vlerësimi tatimor është lënë në fuqi, sepse është konsideruar detyrim i palës paditëse për të deklaruar në organet tatimore dhe për të siguruar në mënyrë të detyrueshme këta punonjës, që janë gjetur në kantierin e ndërtimit dhe kryenin punimet në të.

Pala Paditëse Shoqëria "Pema Konstruksion" sh.p.k, ndodhur në këto rrethana, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, me datë 18.04.2014 i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi.

II. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka shqyrtuar çështjen ka rrëzuar kërkesë padinë duke arsyetuar ndër të tjera se:

Gjykata arrin në konkluzionin se padia e paraqitur prej paditësit duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova dhe në ligj.

Gjykata e cmon të papranueshëm pretendimin e palës paditëse se administratori i saj nuk i njihte punonjës të firmave nënkontraktore, sepse puna kishte vetëm 1 ditë që kishte filluar. Në kantierin e ndërtimit mund të hyjnë vetëm punonjës të autorizuar, duke u ndaluar të hyjnë persona të tjerë, c'ka e përjashton mundësinë që këta 5 persona të ishin të rastësishëm dhe të mos ishin punonjës. Në kushtet kur nuk u provua se ata ishin punonjës të 2 nënkontraktorëve, atëherë ata kanë qenë punonjës të ndërtuesit që i përkiste kantieri, pra palës paditëse shoqëria Pema Konstruksion sh.p.k, e cila kishte dhe detyrimin e deklarimit të tyre në organet tatimore dhe pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në kushtet kur nuk e ka përmbushur këtë detyrim ajo është gjobitur sipas përcaktimeve të nenit 119/1/a, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Lidhur me dy punonjës Flor Kotarja dhe Ardjan Aka, pala paditëse ka pretenduar se ata kanë qenë punonjës të dy nënkontraktorëve, madje Flor Kotarja rezulton punonjës i deklaruar për muajin Shtator nga shoqëria FAEA EVER sh.p.k. Pala e paditur Drejtoria Rajonale Lezhë ka

prapësuar se në deklaratën e sigurimeve shoqërore të kësaj shoqërie për muajin Shtator 2012 rezulton të jetë regjistruar Florie Kotarja dhe jo Flor Kotarja. Pasi ka analizuar këto qëndrime të palëve ndërgjyqëse në raport me këtë deklaratë të sigurimeve shoqërore, Gjykata vlerëson se nga shoqëria FAEA EVER sh.p.k. është regjistruar një person me identitet të ndryshëm nga punonjësi i gjetur në kantierin e ndërtimit të palës paditëse. Megjithatë ai dhe punonjësi tjetër Ardjan Aka nuk janë punonjës të deklaruar prej dy nënkontraktorëve, rezulton se ata janë punonjës të punësuar nga pala paditëse, në ngarkim të së cilës bie detyrimi ligjor i parashikuar për punëdhënësin nga neni 9 dhe 13, i Ligjit Nr.7703/1993 "Për Sigurimet Shoqërore" për të paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të saj dhe detyrimi i parashikuar nga neni 119, i Ligjit Nr.9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", për deklarimin e tyre në organet tatimore dhe pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në përfundim të kësaj analize ligjore dhe faktike, Gjykata cmon se detyrimet tatimore, kamatvonesat dhe gjobat që përcaktojnë aktet administrative objekt gjykimi lidhur me 7 punonjësit e padeklaruar, janë vendosur në përputhje me përcaktimet ligjore të nenit 119, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndaj dhe njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.5859, datë 27.11.2013 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë ndaj palës paditëse, si dhe vendimi nr.22006/1, datë 04.03.2014 i Drejtorisë së Apelit Tatimor që e ka lënë në fuqi atë, duhet të mbeten në fuqi.

III. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Gjykata Administrative e Apelit, si vlerësoi se ka kompetencë lëndore dhe funksionale në shqyrtimin e kësaj çështje, kompetencë e cila i buron nga nenet 7 e 10 të ligjit nr 49/2012, vuri në diskutim dhe vlerësoi akt-gjykimin në shkallë të parë, në vështrim të të drejtës së palëve për proces të rregullt ligjor. Gjykata ka parasysh këtu se kërkesat që lidhen me ligjshmërinë e procesit, bëjnë pjesë në kërkesat procedurale absolute, si të tilla merren në shqyrtim edhe kryesisht nga gjykata.

Gjykata thekson, se e drejta e çdo individi për proces të rregullt ligjor, është një karakteristikë e pandashme e shtetit të së drejtës. Nisur nga ky konceptim për të drejtën dhe shtetin e së drejtës vjen përfundimi logjik se, asnjë personi, palë në një proces gjyqësor, nuk mund të fitojë apo të humbasë të drejta që janë rrjedhojë e procesi të parregullt ligjor, ku të drejtat për një gjykim të paanshëm nga një gjykatë e krijuar me ligj, sipas parimit të iniciativës së lirë të palëve dhe të kontradiktoritetit të gjykimit, nuk janë respektuar. Këto të drejta tashme gëzojnë mbrojtje të merituar se paku nga dy norma të nivelit të lartë juridik, sikurse janë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ. Bazuar në këto akte juridike, K.Pr.Civile dhe Ligji Nr 49/2012, ne disa dispozita, kanë deduktuar rregullat, mbi të cilat duhet zhvillohet gjykim i një çështje civile, për të garantuar këtë standard kushtetues. Këto rregulla procedurale, në tërësinë e tyre përbejnë garancinë për palët së pretendimi i tyre do të trajtohet drejtësisht dhe në mënyrë të paanshme nga gjykata.

Nga ky vlerësim, Gjykata Administrative e Apelit, nuk konstatoi shkelje të normave procedurale, të cilat pas sjellin cënim të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor, dhe që

K.Pr.Civile dhe Ligji Nr.49/2012 i lidh me pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit.

Çështja është regjistruar në këtë gjykatë mbi bazën e ankimit të palës paditëse, e cila ka kundërshtuar vendimin përfundimtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe përmes këtij ankimi kërkon nga Gjykata e Apelit të vendosë ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë së paditësit. Kjo gjykatë, pranoi për shqyrtim ankimin, pasi vlerësoi se i plotëson kushtet formale dhe përmbajtësore të pranueshmerisë, parashikuar nga nenet 44, 45 e 46, të Ligjit Nr.49/2012 dhe 442-447, të K. Pr. Civile, sikurse ka vlerësuar edhe Gjykata e Shkallës së Parë në vendimin respektiv të marrë për këtë fakt, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 46, i ligjit nr 49/2012.

Referuar shkaqeve të parashtruara në ankim nga pala paditëse, argumenteve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj, pretendimeve të palëve dhe provave të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ankimi i paditësit nuk përmban shkaqe për çënimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë si ka shqyrtuar çështjen, ka konkluduar në pranimin e kërkesë padisë, duke arsyetuar ndër të tjera se *“Akti administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore 5859, datë 27.11.2013, është i bazuar në ligj e prova, njëherësh ka cmuar se pretendimet e paditësit për mosvertetimin e shkëljes administrative të parashikuar nga neni 119 i ligjit për procedurat tatimore nuk janë të bazuara.*

Pala paditëse, duke pretenduar se vendimit i Gjykatës së Shkallës së parë vjen në kundërshtim me ligjin dhe me provat, i është drejtuar me ankim Gjykatës Administrative të Apelit duke parashtruar ato shkaqe që janë pasqyruar hollësisht në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Duhet theksuar fakti që paditësi parashtron në ankim të njëjtat pretendime me pretendimet e ngritura në padi të cilat janë shqyrtuar nga gjykata e shkallës së parë dhe janë rrëzuar. Në mënyrë të përmbledhur palët e paditura pretendojnë se, nuk ka patur të punësuar të padeklaruar, personat që janë gjetur nga administrata tatimore nuk ishin të punësuar të paditësit por të një subjekti tjetër nenkontraktor i cili kishte marrë përsipër kryerjen e disa punimeve në objekt. Pala e paditur nuk vertetoi ligjshmerinë e aktit duke pasur ajo barrën e provës për të vertetuar se akti i nxjerrë prej saj është i ligjshëm dhe i themeltë.

Gjykata e Apelit, vëren se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, është rrjedhojë e interpretimit të drejtë të ligjit dhe analizës korrekte të provave duke arritur në këtë mënyrë në konkluzionin e drejtë se akti administrative që përmba detyrimet tatimore të paditësit, është i ligjshëm dhe i themeltë.

Në përgjigje të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse, për një cilësim të saktë të fakteve që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes, ky kolegji cmon se duhet merret në shqyrtim kuadri ligjor që rregullon marrëdhënien konkrete ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Rezulton se marrëdhëniet juridiko administrative ndërmjet tatimpaguesve

dhe administratës tatimore janë rregulluar nga një paketë ligjore e posacme ku gjejnë zgjidhje të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me te drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesve dhe të administratës tatimore.

Kështu, procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore, janë parashikuar në ligjin nr 9920/2008 “Për procedurat tatimore”.

Duke qenë që, mosmarrëveshja ndërmjet palëve në këtë çështje ka të bëjë pikërisht me aspekte të të drejtës tatimore, dispozitat e këtij ligji do të zbatohen si ndaj personave në mosmarrëveshje ashtu edhe për lëndën objekt gjykimi, konkretisht në përcaktimin e vlefshmerisë së aktit administrativ NjVDT, Nr. 5859, datë 27.11.2013.

Ky kolegji vlerëson se pretendimi i paditësit, ngritur në ankim se punonjësit e gjetur në kantier nuk kanë qenë të punësuar prej subjektit “Pema konstruksion” sh.p.k ,por nga nënkontraktorët “FAEA EVER” sh.p.k dhe personi fizik “Idajet Allmuça” ngelet thjesht një pretendim i pavërtetuar. Sipas aktit të konstatimit datë 26.09.2012, në kantier janë gjetur duke punuar 16 punonjës nga të cilët 5 prej tyre nuk kanë pranuar të identifikohen dhe me pas janë larguar me vrap nga kantieri duke ju shmangur kontrollit tatimor. Ka rezultuar gjithashtu se 9 nga punonjësit e gjetur në kantier i përkasin subjektit fizik Idajet Allmuça dhe “FAEA EVER” sh.p.k të cilët janë deklaruar si të punësuar pranë këtyre subjekteve, ndërsa dy punonjës u identifikuan dhe nuk janë deklaruar në organin tatimor nga asnjë subjekt që operonte në kantierin e ndërtimit. Pala e paditur ka nxjerrë aktin administrativ Njoftim Vlerësimin Nr 5859 datë 27.11.2013, duke e denuar paditësin me gjobë për 16 punonjës të padeklaruar si dhe me detyrimin e pagimit të kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 09/2012. Ky akt është ndryshuar pjesërisht nga DAT Tiranë, e cila ka shfuqizuar detyrimin tatimor për TAP dhe sigurime shoqërore si dhe gjobat në shumën 900.000 leke për 9 punonjës, të cilët kanë rezultuar të deklaruar nga nënkontraktorët “FAEA EVER” sh.p.k dhe personi fizik “Idajet Allmuça”, dhe ka lënë në fuqi aktin për pjesët e tjera, duke lënë në fuqi përfundimisht gjobën për mosdeklarim të 7 punonjësve në shumën 700.000 lekë dhe detyrimet tatimore TAP dhe sigurimet shoqërore për këta punonjës.

Gjykata e Apelit vlerëson se, referuar ligjit për procedurat tatimore dhe akteve në zbatim të tij, kontrolli për konstatimin e kundravajtjeve për mos deklarim të të punësuarve sipas nenit 119 të ligjit nr 9920/2008, kryhet në formën e vizitës fiskale mbi bazën e një autorizimi që paraqet inspektori tatimor në momentin e kontrollit. Në këtë kuadër edhe procesi procedural paraprak që i paraprin aktit administrativ kryhet në vend biznes ku tatimpaguesi mund të shprehe edhe opinionin e tij lidhur me faktin e konstatuar dhe procedurën e ndjekur nga inspektori. Fakti që inspektorët e kontrollit tatimor kanë konstatuar në kantierin e ndërtimit ku sipërmarrës ishte paditësi, 7 persona të cilët po kryenin punë në ndërtim dhe nuk janë deklaruar dhe siguruar nga asnjë subjekt tatimpagues, ngarkon me përgjegjësi shoqërore sipërmarrëse që është Pema Konstruksion. Në kushtet kur ajo ka nënkontraktuar një pjesë të punimeve dy subjekteve të tjerë punonjësit e të cileve ishin duke punuar por edhe ishin deklaruar në organin tatimor konform ligjit nr. 9920/2008 nga nënkontraktorët, për personat e gjetur duke punuar dhe nuk

ishin deklaruar në organin tatimor i bie barra e provës paditësit si përgjegjëse e kantierit dhe sipërmarrëse e punimeve të ndërtimit, të vërtetojë se ata nuk i përkasin asaj por shoqërive nënkontraktore.

Si përfundim, ky kolegji çmon se akti administrativ, NJVDT Nr 5859, datë 27.11.2013, për pjesën që është lënë në fuqi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, është i bazuar në ligj, ndërsa pretendimet e paditësit për paligjshmërinë e këtij akti janë të pambështetura në ligj e prova.

Duke vlerësuar se me arsyetimin si më sipër, iu është dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse, ky kolegji njëherësh arrin në përfundimin se shkaqet e ngritura në ankim nuk çenojnë bazueshmërinë në ligj e prova të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 50, gërma “b”, të ligjit Nr. 49 datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar me ligjin 100/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit **Nr. 3920**, datë 08.07.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë **20.10.2016**.

Anëtar
Amarildo LAÇI

(d.v)

Anëtare
Lindita SINANAJ

(d.v)

Kryesues
Bari SHYTI

(d.v)

E njëjtë me origjinalin